

Monitorimi i Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike

Periudha e monitorimit:
Dhjetor 2015 – Dhjetor 2017



Hyrje

Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike (SMAP) 2015-2020¹ dhe Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie 2015-2017² janë miratuar nga Qeveria në shtator 2015³. SMAP është strategjia e parë e miratuar nga Qeveria në numrin prej katër dokumenteve që e përbëjnë kornizën strategjike për reformën e administratës publike në Kosovë.

SMAP përmban tri objektiva strategjike:

- 1) shërbimi civil,
- 2) procedurat administrative dhe ofrimi i shërbimeve publike dhe
- 3) organizimi i administratës publike dhe llogaridhënia.

Të tri objektivat strategjike janë të ndara në objektiva specifike dhe secila objektivë specifike ka një numër të aktiviteteve, institucionin përgjegjës, ndikimin buxhetor dhe cakun ku synohet të arrihet përmes realizimit të aktiviteteve përkatëse.

Instituti GAP ka bërë monitorimin e përmbushjes së këtyre aktiviteteve për periudhën dhjetor 2015 – dhjetor 2017. Monitorimi është bërë përmes diskutimeve me departamentet përkatëse në Ministrinë e Administratës Publike (MAP), analizimit të raporteve dhe dokumenteve tjera publike, dhe diskutimeve me një numër të ministrive për të konfirmuar përmbushjen apo jo të atyre aktiviteteve të cilat implikojnë edhe ministrinë tjera të Qeverisë. Në numrin prej 21 ministrive, si mostër për hulumtim janë marrë tetë ministri të cilat janë zgjedhur në bazë të madhësisë së tyre shprehur në numër të punëtorëve: tri me numrin më të madh të punëtorëve (Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit,

Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Drejtësisë), dy me numrin më të vogël (Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike⁴ dhe Ministria e Integritimit Evropian) dhe tri me numër mesatar të punëtorëve (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim).

Plani i veprimit 2015-2017, përmban 54 aktivitete të cilat është dashur të realizohen gjatë kësaj periudhe. Nga gjithsej 54 aktivitete, 16 janë kryer plotësisht. Në anën tjetër, 22 aktivitete tjera janë në faza të ndryshme të realizimit, kurse 16 të tjera nuk janë kryer dhe se do duhet të bartën në Planin e Veprimit 2018-2020. Në krahasim me zbatimin e planit të veprimit nga monitorimi i bërë vitin e kaluar nga Instituti GAP⁵, mund të thuhet se ka pasur një përmirësim. Të gjitha aktivitetet sipas tri objektivave strategjike janë listuar në tabela më poshtë dhe për secilin aktivitet është shënuar progresi me pak fjalë dhe statusi aktual i klasifikuar në tri ngjyra sipas klasifikimeve të më poshtme:

Aktiviteti është kryer	✓
Aktiviteti është në proces	...
Aktiviteti nuk është kryer	✗

Tabela në vazhdim paraqet një ndarje të aktiviteteve sipas përmbushjes së tyre në të tri objektivat strategjike.

Tabela 1: Aktivitetet e ndara sipas realizimit të tyre në tri objektivat strategjike

	numri i aktiviteteve të kryera	numri i aktiviteteve në proces	numri i aktiviteteve të pakryera	total
Shërbimi civil	8	7	3	18
Procedurat administrative dhe ofrimi i shërbimeve publike administrative	7	11	7	25
Organizimi i administratës publike dhe llogaridhënia	1	4	6	11
Total	✓ 16	... 22	✗ 16	☰ 54

1 Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike (SMAP) 2015-2020: <http://bit.ly/2g9yuwb>

2 Plani i Veprimit për zbatimin e SMAP 2015-2017: <http://bit.ly/2h1MUAE>

3 Vendimi 04/51 i datës 25 shtator 2015: <http://bit.ly/1WA5Rse>

4 Numri i punëtorëve përfshinë vetëm Ministrinë e Diasporës pa përfshirë edhe pjesën e investimeve strategjike e cila është shtuar më vonë si pjesë e portofolios së ministrisë dhe pritet të rritë numrin e punëtorëve.

5 Zbatimi i Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike, periudha e monitorimit tetor 2015 – tetor 2016: <http://bit.ly/2uQBS9Y>

Zbatimi i objektivit të parë strategjik:

Shërbimi Civil

numri i
aktiviteteve
të kryera



8

numri i
aktiviteteve
në proces



7

numri i
aktiviteteve
të pakryera



3

Grafi 1: Ndarja e 18
aktiviteteve sipas
realizimit të tyre

A

F

Zhgnj

Plani i veprimit për zbatimin e SMAP në fushën e shërbimit civil përmban 18 aktivitete të cilat janë të grupuara nën katër objektiva specifike. Sa i përket aktiviteteve të para që kanë të bëjnë me harmonizimin e pozitive ekzistuese me ato që janë paraparë në katalog, si procese nga MAP janë kryer por mungon zbatimi i tyre si pasojë e mungesës buxhetore ngase ndikimi financiar është vlerësuar të jetë rreth 3.5 milionë euro. Nga një numër prej rreth 7.000 pozitive, katalogu i vendeve të punës ka harmonizuar ato dhe tani katalogu numëron rreth 1.500 pozita. Katalogu i miratuar nga Qeveria në shkurt 2015⁶ është plotësuar edhe më një numër prej rreth 145 pozitive specifike.

Sa i përket aktivitetit rreth finalizimit të klasifikimit të vendeve të punës dhe zbatimit të sistemit të ri të pagave sipas klasifikimit, sipas raportit për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2016⁷, një numër prej 106 institucioneve e kanë kryer klasifikimin derisa janë edhe 31 institucione dhe agjenci në nivel qendror të cilat ende nuk e kanë finalizuar klasifikimin. Në këtë grup prej 31 institucioneve bëjnë pjesë edhe pesë institucionet e pavarura sipas Kapitullit XII të Kushtetutës⁸ dhe Gjykata Kushtetuese.

Arsyeja e mos kryerjes së klasifikimit nga këto gjashtë institucione të pavarura del nga Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i dhjetorit 2016 i cili shkurtimisht shpjegohet në vijim. Në funksion të zbatimit të Rregullores për klasifikimin e vendeve të punës⁹ dhe Katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil, MAP përmes një Qarkore Administrative të nxjerrë në janar 2016¹⁰ ka kërkuar nga të gjitha institucionet që kanë të punësuar nëpunës civil që të përgatisin dhe të dërgojnë për aprovim në MAP propozimet e tyre për klasifikimin e vendeve të punës dhe harmonizimin me katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil. Kjo kërkesë ishte kontestuar nga Avokati i Popullit i cili kishte parashtruar kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në prill 2016 për vlerësimin e kushtetutshmërisë së qarkores në fjalë. Sipas parashtruesit të

kërkesës, me këtë qarkore administrative është shkelur garancia kushtetuese e pavarësisë së Avokatit të Popullit të paraparë me nenin 133 të Kushtetutës dhe të institucioneve tjera të pavarura të cekura në Kapitullin XII të Kushtetutës dhe Gjykatës Kushtetuese sipas Kapitullit VIII të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese kishte nxjerrë aktgjykim në dhjetor 2016 se qarkorja administrative në tërësi cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura të parapara me Kushtetutë dhe është jo kushtetuese në raport me ato institucione të pavarura sipas Kapitullit XII dhe Gjykatës Kushtetuese sipas Kapitullit VIII të Kushtetutës.¹¹

Sa i përket aktiviteteve që kanë të bëjnë me instalimin e sistemit informativ elektronik për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ), sistemi është dizajnuar dhe instaluar në të gjitha institucionet dhe është duke vazhduar integrimi i të dhënave personale dhe të punësimit nga dosjet fizike në këtë sistem. Sipas MAP-it, Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil (DASHC)¹², rreth 35% e institucioneve e kanë kryer bartjen (integrimin) e shënimeve nga dosjet fizike në SIMBNJ. Po ashtu, është kryer lidhja e këtij sistemi me trustin pensional dhe sistemin e pagave dhe janë trajnuar menaxherët e personelit në të gjitha institucionet në përdorimin e SIMBNJ. Një sfidë tjetër përveç finalizimit të klasifikimit të vendeve të punës është edhe hartimi i Ligjit për shërbimin civil dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj. Sipas MAP-it dhe prioriteteve kyçe për 2018 të Agjendës së Reformave Evropiane (ARE), pakoja ligjore për reformën e administratës publike ku bënë pjesë edhe Ligji për shërbimin civil do të miratohet në Qeveri në muajin qershor 2018.¹³

Disa aktivitete në proces janë ato që kanë të bëjnë me avancimin e sistemit elektronik për menaxhimin e trajnimeve, zhvillimi i një programi të ekselencës në administratën publike dhe aktiviteti rreth zhvillimit të sistemit rreth vlerësimit të ndikimit të trajnimeve për nëpunësit civil.

6 Vendimi 05/12 i datës 05 shkurt 2015: <http://bit.ly/1c0n5fU> derisa Katalogu i vendeve të punës në shërbimin civil është i qasshëm përmes këtij linku: <http://bit.ly/2DHoGcm>

7 Raporti për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2016, f.13-14 janë të listuara institucionet e nivelit qendror dhe local të cilat kanë kryer dhe ato që nuk e kanë kryer procesin e klasifikimit të vendeve të punës: <http://bit.ly/2n428t1>

8 Pesë institucionet e pavarura sipas Kapitullit XII të Kushtetutës janë: Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Banka Qendrore e Kosovës dhe Komisioni i Pavarur i Mediave.

9 Rregullore nr. 05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil: <http://bit.ly/2ri5Yz5>

10 Qarkore Administrative nr. 01/2016 e nxjerrë më 21 janar 2016: <http://bit.ly/2DvEqMk>

11 Aktgjykim në rastin nr. K073/16: <http://bit.ly/2G8ANxE>

12 Intervistë me Tefik Mahmuti, Drejtor i Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil, datë: 24 nëntor 2017

13 Vendimi 01/13 i datës 10 nëntor 2017: <http://bit.ly/2G4TT7R>

Objektivi strategjik 1: Shërbimi civil

Tabela 2: Aktivitetet e parapara të ndërmerren dhe progresi i arritur:


Nr.	Aktiviteti	Produkti (rezultati final)	Progresi	Statusi
1.	Harmonizimi i pozitave sipas katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil	Lista e pozitave të harmonizuara me katalogun e vendeve të punës	Është kryer. Është bërë harmonizimi i rreth 1.500 vendeve të punës	
2.	Plotësimi i katalogut me pozita të reja dhe përshkrime të standardizuara të detyrave të punës për pozitat specifike të cilat nuk janë në katalog	Katalogu i plotësuar	Është kryer. Katalogu është plotësuar edhe me 145 tituj të vendeve të punës	
3.	Finalizimi i klasifikimit të vendeve të punës të shërbimit civil dhe zbatimi i sistemit të ri të pagave	Klasifikimi i vendeve të punës i miratuar nga Qeveria	Në proces. Nuk është kryer klasifikimi edhe për 31 institucione dhe agjenci në nivel qendror. Mungon zbatimi për pjesën e kryer si pasojë e buxhetit	
4.	Integrimi i të dhënave personale dhe të punësimit të nëpunësve civil në formë elektronike nga dosjet fizike në SIMBNJ, nga të gjitha institucionet	Të dhënat e integruara nga të gjitha institucionet	Në proces. Deri tani 35% e institucioneve në nivel qendror dhe lokal e kanë kryer këtë proces	
5.	Zhvillimi i moduleve të reja (Planifikimit të Personelit, Aplikimi Online duke përfshirë edhe procedurat e rekrutimit për nivelin e lartë drejtues)	Modulet e reja të zhvilluara dhe të funksionalizuara	Në proces	
6.	Ndërlidhja e SIMBNJ-së me sistemin e pagave dhe me trustin pensional	SIMBNJ i ndërlidhur me sistemin e pagave dhe me trustin pensional	Është kryer	
7.	Trajnimi i menaxherëve të personelit dhe zyrtarëve përgjegjës për përdorimin e SIMBNJ-së, sipas nevojës	Numri i të trajnuarve	Është kryer	
8.	Monitorimi i zbatimit të legjislacionit të SHC	Raportimi periodik dhe përcjellja e rekomandimeve në Qeveri	Është kryer	
9.	Plotësimi ndryshimi i Ligjit për Shërbimin Civil me qëllim të organizimit dhe funksionalizimit të shërbimit civil me funksional dhe jopolitik	Ligji i miratuar	Nuk është kryer. Planifikohet për qershor 2018.	

Nr.	Aktiviteti	Produkti (rezultati final)	Progresi	Statusi
10.	Hartimi i akteve përkatëse nënligjore të cilat dalin nga plotësim-ndryshimi i Ligjit për SHC	Aktet nënligjore të miratuara	Nuk është kryer	
11.	Pilotimi i zhvillimit të testimit dhe vlerësimit në formë elektronike për avancim dhe rekrutim në shërbimin civil	Pilot projekti i realizuar	Është kryer. Sistemi është i gatshëm dhe është kryer pilotimi. Mbetet të zbatohet nga institucionet.	
12.	Trajnimi i menaxherëve të personelit dhe zyrtarëve përgjegjës të institucioneve më ndryshimet e reja në legjislacionin e SHCK-së (menaxheri i personelit dhe një zyrtar)	Numri i zyrtarëve të trajnuar	Nuk është kryer	
13.	Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Trajnimeve të Nëpunësve Civil 2015-2019	Strategjia e miratuar	Është kryer	
14.	Hartimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë së trajnimeve	Plani i veprimit i miratuar	Është kryer	
15.	Avancimi i sistemit elektronik për menaxhimin e trajnimeve në IKAP	Sistemi i menaxhimit të trajnimeve i zhvilluar dhe funksional	Në proces. Janë kryer fazat si: specifikacioni i projektit, procedurat e prokurimit dhe është përzgjedhur organizata që do të zhvillojë platformën elektronike	
16.	Krijimi dhe zhvillimi i sistemit të kreditëve për trajnimet e zhvillimit të karrierës dhe të detyrueshme	Sistemi i kreditëve i miratuar	Në proces. Është kryer faza e parë e projektit	
17.	Organizimi i programit të ekselencës në administratën publike	Programi i ndërtuar dhe funksional	Në proces. Janë zhvilluar trajnimet për kornizën e përbashkët të vlerësimit (ang.CAF) por mungon zbatimi në praktikë	
18.	Krijimi i mekanizmave (sistemit) për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve	Mekanizmat të strukturuar dhe krijuar	Në proces. Është hartuar procedura e trajnimit, janë zhvillur aplikacionet për vlerësimin e ndikimit dhe janë përcaktuar të mbahen dy trajnime	

Zbatimi i objektivit të dytë strategjik:

Procedurat administrative dhe ofrimi i shërbimeve publike administrative

Grafi 2: Ndarja e 25 aktiviteteve sipas realizimit të tyre



Objektivi strategjik numër dy, ka numrin më të madh të aktiviteteve, gjithsej 25 të grupuara nën gjashtë objektiva specifike. Sa i përket aktiviteteve të para që kanë të bëjnë me pjesën e ofrimit të shërbimeve publike-administrative, është bërë identifikimi i shërbimeve publike-administrative që ofrohen nga administrata publike por procesi ende nuk është finalizuar. MAP është në proces të përditësimit dhe korrjimit të disa të dhënave në këtë databazë dhe pastaj do të bëhet edhe publikimi i saj në uebfaqe të MAP. Publikimi i listës është po ashtu një prej aktiviteteve në këtë fushë dhe po ashtu kjo databazë do të përfshijë edhe të dhënat e kontaktit për secilin institucion dhe personin i cili është përgjegjës për ofrimin e shërbimit përkatës (aktivitet tjetër i paraparë me plan të veprimit). Sipas konsultimeve me përfaqësues të MAP në këtë fushë, është theksuar fakti i përsëritjes së disa aktiviteteve në plan e të cilat do të duhej të ishin në një aktivitet, për shembull: identifikimi i shërbimeve, lista kontaktuese e institucioneve që ofrojnë këto shërbimeve, personat kontaktues për ofrimin e këtyre shërbimeve dhe publikimi i databazës me komplet këto të dhëna do të duhej të ishte një aktivitet¹⁴. Përfaqësuesit e MAP-it thonë se ministria është në proces të rishikimit të tërë funksionit në ofrim të shërbimeve si: funksionet që aktualisht ka MAP në këtë fushë, nëse MAP ka njësi/strukturë përgjegjëse për ofrim të shërbimeve¹⁵. Analiza e rishikimit të funksioneve të MAP në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe analiza që rekomandon krijimin e një strukturë brenda MAP-it përgjegjëse vetëm për ofrim të shërbimeve (me funksione të politik-bërjes dhe koordinimit) janë hartuar mirëpo rekomandimet ende nuk janë zbatuar.

Në fushën e procedurave administrative, MAP ka hartuar dhe Kuvendi ka miratuar në maj 2016 Ligjin për procedurat e përgjithshme administrative i cili vendos një kornizë apo standard të procedurave administrative dhe si rezultat të gjitha procedurat tjera të veçanta administrative të përcaktuara me ligje tjera do të duhet të përshtaten me ligjin në fjalë. MAP është në proces të rishikimit të të gjitha ligjeve që mund të përcaktojnë një procedurë tjetër administrative që nuk është në përputhje me ligjin aktual dhe do të rekomandojë plotësimin dhe ndryshimin e të gjithë atyre ligjeve në mënyrë që këto të jenë në përputhje me Ligjin për procedurat e përgjithshme administrative.¹⁶

Edhe disa aktivitete tjera në këtë fushë janë në proces si: hartimi i një manuali për zbatim të ligjit, trajnimi i zyrtarëve nëpër institucione të ndryshme që do të zbatojnë drejtpërdrejt ligjin dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me vetëdijësimin e publikut (OJO-ve, bizneseve, asociacioneve të ndryshme) rreth ndikimit në procedura administrative të Ligjit për procedurat e përgjithshme administrative.

Në fushën e ndërlihdjes së sistemeve apo të bazave të të dhënave që do të ndihmonte në integrimin e tyre dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në një pikë, sipas përfaqësuesve të MAP në këtë fushë, këtë vit është planifikuar të kryhet platforma kryesore e interoperabilitetit që do të mundësojë pastaj edhe lidhjen e sistemeve¹⁷. Në këtë aspekt, është lidhur kontratë me kompaninë Microsoft dhe nga 2017 janë ndarë buxhet për tri vite nga rreth 400,000 euro që do të mundësojnë zhvillimin e platformës dhe lidhjen e sistemeve nga 10-15 sisteme për çdo vit.¹⁸ Aktivitete që nuk janë kryer dhe nuk janë në proces në këtë fushë janë: krijimi i portalit E-Kosova, zhvillimi i infrastrukturës dhe platformës së Çelësave Publik dhe ndërtimi i pikave të vetme të kontaktit për ofrimin e shërbimeve. Një proces që ka filluar gjatë vitit 2017 dhe është në proces është vendosja e kutive për marrjen e opinionit të qytetarëve në ofrimin e shërbimeve, apo matja e kënaqshmërisë së qytetarëve me ofrimin e shërbimeve nga administrata publike. Deri tani këto kuti (e-kutia) janë vendosur në 35 institucione në total dhe është planifikuar që të mbulohen të gjitha institucionet në vitet në vijim. Për 35 institucione ku janë vendosur kutitë, MAP ka pranuar rregullisht vlerësimet e qytetarëve që janë përmes e-kutive dhe këto vlerësime me një numër të rekomandimeve do të dërgohen nga MAP për këto institucione ku janë të vendosura e-kutitë.

Nëse e shohim se sa aktivitete janë kryer nga gjithsej 25, sa janë nuk janë kryer dhe sa janë në proces, vërejmë se shumica e aktiviteteve janë në proces, një është kryer derisa shtatë tjera nuk janë kryer.

14 Intervistë me Naser Shamolli, Drejtor i Departamentit Ligjor në MAP, datë: 22 nëntor 2017.

15 Ibid.

16 Ibid.

17 Deri tani janë integruar katër sisteme: Regjistri Civil, Sistemi i Tatimit në Pronë, Sistemi i Regjistrimit të Adresave dhe Sistemi i Noterisës.

18 Intervistë me Burim Balaj, Drejtor i Drejtoratit për Racionalizimin e Proceseve Administrative, Agjencia për Shoqërinë e Informacionit në MAP, datë: 22 nëntor 2017.

Objektivi strategjik 2: Procedurat administrative dhe ofrimi i shërbimeve publike administrative

Tabela 3: Aktivitetet e parapara të ndërmerren dhe progresi i arritur:


Nr.	Aktiviteti	Produkti (rezultati final)	Progresi	Statusi
1.	Identifikimi i shërbimeve publike administrative që ofrohen nga AP	Lista mbi ofrimin e shërbimeve për secilin institucion	Në proces. Është krijuar një databazë e cila është duke u përditësuar dhe do të finalizohet.	
2.	Analiza e shërbimeve administrative të identifikuara nga raportet paraprake	Raporti mbi rezultatin e analizës	Nuk është kryer	
3.	Hartimi i kornizës politike dhe strategjike për ofrimin e shërbimeve në të mirë dhe sa më pranë qytetarëve dhe bizneseve	Korniza strategjike	Në proces	
4.	Miratimi i Ligjit për Procedurat e Përgjithshme Administrative (LPPA)	Ligji i miratuar në Kuvend	Është kryer	
5.	Analiza e procedurave të veçanta në raport me LPPA	Raporti i analizës i përfunduar	Në proces. Është duke u bërë një analizë e ligjeve që parashohin procedura të veçanta administrative për t'u përshtatur me LPPA	
6.	Hartimi i manualit për zbatimin e LPPA	Manuali i miratuar	Në proces. Një draft është hartuar por ende nuk është finalizuar	
7.	Trajnimi i nëpunësve civil mbi LPPA	Rreth 1,300 të punësuar të trajnuar	Në proces. Është bërë hartimi i programit për trajnim derisa trajnimi pritet të fillojë në shkurt 2018	
8.	Vetëdijësimi i opinionit publik për LPPA	10,000 cope kopje të ligjit të printuara dhe 10,000 fletushka informuese	Në proces. Janë mbajtur dy tryeza si diskutim në nivel qendror për LPPA dhe gjashtë tjera janë mbajtur në gjashtë regjione ku janë përfshirë të gjitha komunat	
9.	Analiza e rishikimit të funksioneve të MAP lidhur me shërbimet publike-administrative	Dokumenti i analizës i prodhuar dhe i konsultuar	Në proces. Është bërë një analizë por ende nuk është finalizuar	
10.	Rishikimi i Rregullores për organizimin e brendshëm të MAP-it	Rregullorja e rishikuar dhe miratuar	Rregullorja për organizimin e brendshëm të MAP është miratuar në fund të janarit 2018	
11.	Krijimi i njësisë (strukturës) përgjegjëse për udhëheqjen, planifikimin, monitorimin, vlerësimin dhe zbatimin shërbimeve publike-administrative	Njësia (struktura) e krijuar	Në proces. Është bërë një analizë e të gjitha strukturave që ofrojnë shërbime dhe janë dhënë rekomandimet për krijimin e strukturës dhe funksioneve të saj në kuadër të MAP por njësia ende nuk është krijuar	

Nr.	Aktiviteti	Produkti (rezultati final)	Progresi	Statusi
12.	Hartimi i metodologjisë për me-naxhimin e procesit për vlerësimin e shërbimeve publike-administrative	Metodologjia e hartuar dhe zyrtarët e trajnuar	Në proces. Është bërë një analizë mbi praktikat edhe të vendeve tjera por metodologjia ende nuk është finalizuar	...
13.	Zhvillimi i platformës kryesore të Interoperabilitetit (të ndërveprimit të sistemeve) dhe fillimisht integrimi shtatë (7) sistemeve	Platforma e dizajnuar dhe funksionalizuar	Në proces. Janë lidhur kater sisteme dhe platforma pritet të kryhet gjatë 2018	...
14.	Në kuadër të projektit Platforma Kryesore e Interoperabilitetit do të ndërlidhen katërbëdhjetë (14) sisteme	Pasurimi i platformës me (katërbëdhjetë) 14 sisteme	Në proces. Është planifikuar që nga janari 2018 të lidhen nga 10-15 sisteme për vit. Është lidhë kontrata me Microsoft për zhvillim të platformës dhe lidhje të sistemeve	...
15.	Në kuadër të projektit Platforma Kryesore e Interoperabilitetit do të ndërlidhen dhjetë (10) sisteme	Pasurimi i platformës me dhjetë (10) sisteme	Nuk është kryer	—
16.	Zhvillimi dhe funksionalizimi i platformës dhe infrastrukturës së Çelësave Publik për zyrtarë (PKI)	Zhvillimi dhe funksionalizimi i platformës	Nuk është kryer	—
17.	Portali e-Kosova	Portali i krijuar dhe zhvilluar	Nuk është kryer	—
18.	Ndërtimi i dy pilot-pikave të vetme të kontaktit	Dy (2) pilot pikat e ndërtuara dhe 30% e shërbimeve të ofruara përmes këtyre dy pikave	Nuk është kryer	—
19.	Analiza për shtrirjen e shërbimeve publike administrative që mund të kryhen përmes pikave të vetme të kontaktit	Raporti i analizës i përfunduar	Në proces	...
20.	Publikimi i listës së shërbimeve administrative, kohëzgjatja e realizimit, kriteret si dhe kostoja për realizimin e tyre	Lista e publikuar	Nuk është kryer	—
21.	Publikimi i të dhënave të kontaktit për çdo institucion dhe për personin i cili është përgjegjës për ofrimin e shërbimit publik administrative përkatës	Të dhënat e kontaktit të publikuara	Nuk është kryer	—
22.	Vendosja e kutive për marrjen e opinionëve në të gjitha IRK-të mbi shërbimet e ofruara	Kutitë e vendosura në të gjitha IRK-të	Në proces. Deri tani janë vendosur në 35 institucione (28 prej tyre janë qeveritare)	...
23.	Hartimi i rregullativës juridike për rregullimin e formave dhe standardeve të marrjes së opinionëve	Rregullativa juridike dhe format standarde të miratuara	Në proces. Është bërë një draft i rregullorës por ende nuk është nënshkruar dhe hyrë në fuqi	✓
24.	Matja e opinionëve përmes formave të tjera (TI, mobile, klasike etj)	Rezultatet e publikuara	Në proces. Është bërë përmes Mystery shopping mirëpo rezultatet nuk janë publikuar ende.	✓
25.	Analiza dhe raportimi i opinionëve	Rezultatet e publikuara	Në proces. Është bërë një analizë dhe të gjeturat do të i'u dërgohen institucioneve ku është bërë matja e opinionëve.	...

Zbatimi i objektivit të tretë strategjik:

Organizimi i administratës publike dhe llogaridhënia

Grafi 3: Ndarja e 11 aktiviteteve sipas realizimit të tyre



Objektivi strategjik numër tre ka më pak aktivitete në krahasim me dy objektivat strategjike të lartpërmendura, me gjithsej 11 aktivitete të grupuara nën katër objektiva specifike. Sa i përket aktivitetit rreth krijimit të bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, koncepti dokumenti është hartuar, ka kaluar fazën e konsultimeve publike dhe është miratuar në Qeveri. Ky ligj është njëri prej tri ligjeve që e përbëjnë pakon ligjore për reformën e administratës publike që sipas prioriteteve kyçe të ERA-s për 2018 është paraparë të miratohet në qershor 2018. Një prej risive në këtë ligj do të jetë përfshirja e agjencive të pavarura, përkatësisht rregullimi i niveleve të organizimit të tyre që kanë qenë të parajtuara në Ligjin paraprak për administratën shtetërore.

Në fushën e Kodit të Etikës në shërbimin civil, është hartuar Kodi i Mirësjelljes në Shërbimin Civil¹⁹, i cili e zëvendëson kodin paraprak të mirësjelljes në shërbimin civil dhe janë mbajtur një numër i trajnimeve me zyrtarët të cilët do të jenë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të tij. Kodi paraqet një dokument obligativ për zbatim nga ana e nëpunësve civil të cilët janë të obliguar ta zbatojnë me të filluar punën në administratën publike. Sa i përket aktiviteteve që lidhen me qasjen në dokumente publike, krijimi i databazës për kërkesat për qasje në dokumente publike ende nuk është kryer ngase funksionalizimi i saj është lidhur me digjitalizimin e arkivës për qasje në dokumente publike; procesi i cili ende nuk ka ndodhur. Lidhur me bazën ligjore për kërkesat për qasje në dokumente publike, koncepti dokumenti është miratuar në Qeveri dhe deri në fund të 2018 pritet miratimi i projektligjit për qasje në dokumente publike.²⁰

Nëse shohim aktivitetet në këtë objektiv të listuara më lartë, vërehet se vetëm një aktivitet është kryer, katër tjera janë në proces derisa gjashtë aktivitete tjera nuk janë kryer.

19 Rregullore nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës: <http://bit.ly/2rPsvaL>

20 Zyra e Kryeministrit, zyra për komunikim publik: Raporti gjithëpërfshirës i institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike: <http://bit.ly/2DJvwLv>

Objektivi strategjik 3: Organizimi i administratës publike dhe llogaridhënia**Tabela 4:** Aktivitetet e parapara të ndërmerren dhe progresi i arritur:

Nr.	Aktiviteti	Produkti (rezultati final)	Progresi	Statusi
1.	Krijimi i bazës ligjore gjithpërfshirëse për organizimin e brendshëm të administratës publike	Baza ligjore e miratuar	Në proces. Koncept dokumenti është miratuar.	
2.	Ri-organizimi i AP sipas bazës së re ligjore	IRK-të të ri-organizuara	Nuk është kryer. Pas miratimit të ligjit si më lartë	
3.	Vendosja e sistemit të monitorimit	Metodologjia e zhvilluar	Nuk është kryer	
4.	Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve për personat përgjegjës për monitorimin e parimeve të etikës dhe transparencës në administratën publike	Numri i të trajnuarve	Nuk është kryer	
5.	Monitorimi dhe zbatimi i Kodit të Etikës në shërbimin civil	Raportet periodike të publikuara	Nuk është kryer	
6.	Krijimi i databazës për kërkesa për qasje në dokumente publike	Krijimi i databazës	Në proces. Databaza është dizajnuar por ende nuk është funksionalizuar	
7.	Krijimi i listës së informatave për të cilat institucionet janë të obliguara t'i publikojnë në uebfaqet e tyre	Listat e publikuara	Nuk është kryer	
8.	Hartimi i koncept dokumentit për politikën e qasjes në dokumente publike	Koncept dokumenti i aprovuar	Është kryer	
9.	Plotësimi i kuadrit ligjor për qasjen në dokumente publike	Ligji për qasje në dokumente publike i rishikuar dhe miratuar	Në proces	
10.	Monitorimi i zbatimit të lejimit të qasjes në dokumente publike	Mekanizmat e monitorimit të përcaktuar	Në proces. Përmes raporteve tre-mujore	
11.	Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për përgjegjësinë e AP	Koncept dokumenti i miratuar	Nuk është kryer	

Përfundime

Në bazë të monitorimit mbi realizimin e aktiviteteve sipas tri objektivave strategjike, Instituti GAP nxjerr këto përfundime rreth zbatimit të planit të veprimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike:

Objektivi strategjik: Shërbimi Civil

Aktivitetet e pakryera dhe ato në proces të planifikuara të kryhen gjatë periudhës 2015-2017 duhet të barten në planin e veprimit 2018-2020;

Procesi i finalizimit të klasifikimit të vendeve të punës është ngadalësuar shumë sidomos në institucionet dhe agjencitë e pavarura të nivelit qendror dhe në këtë vonesë ka ndikuar edhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për institucionet e pavarura të Kapitullit XII të Kushtetutës, përmes të cilit e shpallë jo kushtetuese Qarkoren Administrative 01/2016 të MAP për zbatimin e Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil;

Procesi i integritit të të dhënave të personelit në institucionet që kanë të punësuar nëpunës civil nga dosjet fizike në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është duke vazhduar shumë ngadalë dhe si pasojë deri tani vetëm 35% e të gjitha institucioneve në nivel qendror dhe lokal e kanë kryer këtë proces;

Hartimi i Ligjit për zyrtarët publik që do të zëvendësojë Ligjin për shërbimin civil është vlerësuar me rendësi të lartë dhe miratimi i tij në Qeveri është caktuar të bëhet në qershor 2018;

Klasifikimi i vendeve të punës dhe harmonizimi sipas katalogut të vendeve të punës për pjesën e institucioneve që e kanë kryer këtë proces, nuk është në implementim dhe kjo si pasojë e mungesës së buxhetit i cili është vlerësuar të jetë rreth 3.5 milion euro për vit.

Objektivi strategjik: Procedurat administrative dhe ofrimi i shërbimeve publike administrative

Aktivitetet e pakryera dhe ato në proces të planifikuara të kryhen gjatë periudhës 2015-2017 duhet të barten në planin e veprimit 2018-2020;

Si pasojë e mos ndarjes së buxhetit për këtë aktivitet, ka vonesë të theksuar në zhvillimin e platformës kryesore të interoperabilitetit dhe lidhjes së sistemeve vit për vit. Zhvillimi i platformës është paraparë me plan të veprimit të ndodhë në çerekun e dytë të 2016 derisa ajo pritet të kryhet gjatë vitit 2018 dhe lidhja e sistemeve të ndodhë më vonë;

Matja e kënaqshmërisë së qytetarëve përmes e-kutisë është një projekt i cili duhet të zgjerohet në të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime. Megjithatë, MAP duhet të konsiderojë edhe matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve me ofrimin e shërbimeve publike-administrative edhe në formën fizike përmes pyetësorëve (me ndihmën e ndonjë kompanie profesionale në matjen e opinionit publik).

Objektivi strategjik: Organizimi i administratës publike dhe llogaridhënia

Aktivitetet e pakryera dhe ato në proces të planifikuara të kryhen gjatë periudhës 2015-2017 duhet të barten në planin e veprimit 2018-2020;

Ligji për organizimin e administratës publike i cili do të përfshijë edhe organizimin e agjencive të pavarura, duhet të vazhdojë dhe të arrihet caku për miratimin e tij në Qeveri në qershor 2018;

Përveç koncept dokumentit, hartimi dhe pastaj miratimi i Ligjit për qasje në dokumente publike ka pasur vonesë të theksuar. Miratimi i Ligjit pritet të kryhet gjatë vitit 2018;

Duhet të përfundojë procesi i digjitalizimit të arkivës për qasje në dokumente publike dhe të krijohet databaza për qasje në dokumente publike.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



